




European Union



FONDACIONI
SHOQËRIA
E HAPUR
PËR SHQIPËRINË

Anketimi kombëtar mbi perceptimet & pritshmëritë drejt anëtarësimit të mundshëm të Shqipërisë në BE



Anketimi Kombëtar 2014 mbi Perceptimet dhe Pritshmëritë drejt Anëtarësimit të Mundshëm të Shqipërisë në BE

Përmbledhje e projektit

Prej muajit qershor 2014, Shqipëria është zyrtarisht vend kandidat për anëtarësimin në Bashkimin Europian (BE). Përmirësimi i perceptimit të përbashkët për BE dhe nxitja për një kuptim më të gjerë të institucioneve të saj, vlerave dhe procedurave është një projekt mjaft i rëndësishëm dhe afatgjatë. Pjesa dërrmuese e popullësisë shqiptare vazhdon ta mbështesë fuqimisht integrimin europian. Autoritetet shqiptare dhe BE kanë punuar së bashku për ti adresuar këto çështje. Ka patur progres në rritjen e ndërgjegjësimit dhe të kuptuarit të audiencës shqiptare mbi BE-në.

Gjatë muajve maj-tetor 2014, **Delegacioni i BE në Shqipëri** angazhoi **Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë/Soros** të ndërmerre *“Anketimin Kombëtar 2014 mbi Perceptimet dhe Pritshmëritë drejt Anëtarësimit të Shqipërisë në BE”*. Studimi ofron informacion rreth nivelit të dijes dhe të kuptuarit të qytetarëve shqiptarë mbi BE-në, punën e saj dhe çfarë nënkupton procesi i integrit. Studimi hedh dritë mbi kanalet e informacionit më të përdorura prej tyre kur kërkojnë informacione mbi BE-në dhe integrimin dhe shpjegon faktorët që ndikojnë në formimin e opinionit shqiptar rreth këtyre çështjeve. Gjithashtu, ky studim na ofron njohuri rreth këtyre faktorëve të analizuar mirë, me rekomandime se si mund të përmirësohet komunikimi i BE me qytetarët shqiptarë.

Metodologjia e përdorur

Studimi u krye nëpërmjet intervistave të drejtpërdrejta bazuar mbi metodologjinë e Sondazhit Social Europian dhe duke përdorur variablat e Eurobarometrit për të pasur rezultate të krahasueshme me ato të vendeve të tjera europiane. Kampioni bruto i studimit përbëhej nga 1,602 individë nga i gjithë vendi, të përzgjedhur për të bërë intervista ballë për ballë. Kampioni neto i synuar i studimit përbehej nga 1,208 individë në të gjithë vendin që priteshin të intervistoheshin gjatë punës në terren. Kampioni neto i arritur i këtij studimi përbëhet nga 1,099 individë të intervistuar ballë për ballë në të gjithë vendin midis 14 maj 2014 deri më 22 qershor 2014. Rezultatit e sondazhit kanë një kufi gabimi prej $\pm 3\%$ për një nivel sigurie prej 95%.

Projekti përfshiu një ekip i përbërë prej manaxherit, ekspertit statistikor, ekspertit të teknologjisë, ekspertit të logjistikës dhe burimeve njerëzore, 10 koordinatorë dhe 40 intervistues. Secili intervistues u pajis me një Tablet PC që kishte GPS dhe lidhje interneti 3G/EDGE.

Rezultatet e Shqipërisë krahasohen me rezultatet e vendeve të tjera europiane duke përdorur të dhënat e pesë Eurobarometrave standartë; më specifiku Eurobarometeri 76.1 (2011), Eurobarometeri 77.4 (2012), Eurobarometeri 79.1 (2013), Eurobarometeri 79.2 (2013) and Eurobarometeri 80.1 (2013).

Gjetjet kryesore sipas fushave:

Demografia

- Kampioni përbëhet nga individë të moshës +15 banues në zonat urbane, me 48.9% meshkuj dhe 51.1% femra.
- 62% janë të martuar ligjërisht, 29% janë beqarë, 6% janë të ve, dhe 1% janë të divorcuar.
- 57% shprehen të jenë të fesë myslimane, 14% ortodoksë, 11% katolikë, 6% bektashi, dhe 3% myslimanë sunitë.
- 36% kanë një punë të paguar, 17% janë në pension, 17% janë të papunë, 11% janë me studime, 11% bëjnë punët e shtëpisë. Nga 36% që punojnë, 40% e tyre punojnë në privat, 30% të vetëpunësuar, dhe 15% punojnë në sektorin publik.
- 1% nuk ka asnjë nivel arsimor, 7% ciklin e parë të arsimit fillor, 31% ciklin e dytë të arsimit fillor, 24% arsimin e mesëm të përgjithshëm, 18% arsimin profesional, 18% arsimin e lartë, 5% kanë master ose doktoraturë.
- *Shqipëria është tre vendet e para në Europë me shkallën më të lartë të pabarazisë së të ardhurave.* Shifra mesatare e të ardhurave neto mujore për familje ishte 240 euro, ndërsa për person 80 euro. Shifra mesatare e shpenzimeve mujore për ushqim për familje është 200 euro, ndërsa për person është 54 euro.

Perceptimi mbi BE-në

- Për 72% të shqiptarëve, BE-ja do të thotë liri udhëtimi, studimi dhe pune kudo në BE, për 60% do të thotë demokraci, për 60% do të thotë zhvillim ekonomik dhe 59% do të thotë paqe.
- 66% e shqiptarëve në të ardhmen e afërt e shikojnë veten si shqiptarë dhe si europianë.
- 57% e shqiptarëve mendojnë se ata janë të informuar shumë ose relativisht mirë rreth BE.
- 46% e shqiptarëve nuk njohin ndonjë institucion të BE-së.

Kanalet e informimit

- Qytetarët shqiptarë renditen mes 6 popullsive që shikojnë televizor çdo ditë/pothuajse çdo ditë me 89%, më e lartë se mesatarja e BE prej 84%, dhe e paraprirë nga Portugalia (93%), Bullgaria (93%), Spanja (91%), Kroacia (91%), Rumania (89%).
- Lidhur me frekuencën e përdorimit të internetit çdo ditë/pothuajse çdo ditë, qytetarët shqiptarë renditen të 25-të, me 42%, më e ulët se mesatarja e BE 57%.
- Lidhur me përdorimin e rrjeteve sociale çdo ditë/pothuajse çdo ditë, qytetarët shqiptarë renditen të 11-të me 34%, më e lartë se mesatarja e BE-së prej 33%. Pavarësisht frekuencës së ulët të përdorimit të internetit në krahasim me vendet e tjera, 91% e shqiptarëve që përdorin internet gjithashtu përdorin rrjetet sociale online.
- Për leximin e shtypit shqiptarët renditen të 15-të me 25% të personave që lexojnë shtypin çdo ditë/pothuajse çdo ditë, më e ulët se mesatarja e BE-së prej 33%.
- Televizioni është kanali informues me të cilin shqiptarë kalojnë pjesën më të madhe të kohës. Kështu, shqiptarët shpenzojnë mesatarisht 80.9 orë çdo muaj (2 orë & 40 minuta në ditë).
- Kanali i dytë i informimit i përdorur me orë të gjata është interneti i aksesuar nga kompjuteri, me një mesatare prej 29.8 orë në muaj (1 orë në ditë).
- Kanalet e informimit online & mënyrat e aksesit si Facebook, Interneti në aparatet celulare, YouTube, Internet në kompjuter (PC ose laptop), WhatsApp, Viber, Instagram, Blogjet, gazetatat online dhe interneti në tablet përdoren kryesisht nga personat me moshë të re. Nga ana tjetër kanalet e informimit si TV përdoren kryesisht nga njerëzit e moshuar.

Njohuri mbi BE-në

- Kur pyeten, 87% e shqiptarëve thonë se kanë dëgjuar për Parlamentin Europian, 77% kanë dëgjuar për Komisionin Europian dhe 70% kanë dëgjuar për Bankën Qendrore Europiane.
- 67% e shqiptarëve mendojnë se ata e dinë se çfarë të drejtash kanë qytetarët e BE-së dhe 92% do të donin të dinin më shumë rreth të drejtave qytetarëve BE-së.
- 59% e shqiptarëve nuk e dinë që Zvicra nuk është anëtar i BE-së dhe 66% e dinë se BE përbëhet nga 28 vende anëtare.

Perceptimet/pritshmëritë nga antarësimi në BE

- 77% e shqiptarëve mendojnë se integrimi i Shqipërisë është shumë i rëndësishëm, 18% i rëndësishëm por jo prioritet, dhe 4% aspak i rëndësishëm.
- 87% e shqiptarëve mendojnë se anëtarësimi i Shqipërisë në BE do të jetë diçka e mirë dhe 92% mendojnë se Shqipëria do të përfitojë nga të qenit anëtar i BE-së.
- Sektorët të cilët shqiptarët presin të përmirësohen më shumë gjatë aderimit të Shqipërisë në BE janë a) sistemi arsimor, b) ekonomia shqiptare, c) mbrojtja e mjedisit d) eksporti i produkteve shqiptare dhe e) mirëqeverisja.
- 53% e shqiptarëve mendojnë se vendi është gati t'i bashkohet BE-së, 43% mendojnë se nuk është, dhe 4% nuk e dinë.
- 69% e shqiptarëve mendojnë se BE duhet të na pranoj si një anëtar edhe pse Shqipëria nuk është gati, 27% mendojnë se BE nuk duhet dhe 4% nuk e dinë.
- Nëse të nesërmen do të zhvillohej një referendum mbi anëtarësimin e Shqipërisë në BE, 91% e shqiptarëve do të votonin për të, 5% do të votonin kundra tij, 3% nuk do të hidhnin votën dhe 1% përgjigjet se nuk e di.
- Ekziston një tred për personat me nivel më të lartë arsimor dhe personat me nivel më të ulët besimi ndaj qeverisë shqiptare që të kundërshtojnë anëtarësimin e Shqipërisë në BE.
- 63% e shqiptarëve do ta konsideronin punësimin në një nga shtetet anëtare të BE në 2 deri 5 vitet e ardhshme, me 81% prej tyre që kërkojnë një pagë më të mirë, 41% kërkojnë mundësi zhvillimi profesional dhe 35% e tyre nuk mund të gjejnë një punë në Shqipëri.

Pritshmëritë për të ardhmen

- Problemet kryesore me të cilin shqiptarët po përballen në këtë moment janë: a) papunësia (45%), b) krimi (31%), dhe c) gjendja ekonomike e vendit (30%).
- 71% e shqiptarëve presin që gjendja ekonomike në BE të jetë më e mirë në 12 muajt e ardhshëm. Ky është niveli më i lartë i optimizmit në Europë. Gjithashtu, 58% e shqiptarëve presin që jeta e tyre të jetë më e mirë në 12 muajt e ardhshëm. Kjo është shifra më e lartë në gjithë Europën, duke lënë pas nivelet e optimizmit të Malit të Zi (47.2%), Islandës (43.2%) dhe Suedisë (40.7%).

Korrupsioni

- 87% e shqiptarëve mendojnë se korrupsioni në Shqipëri është më i përhapur se në vendet e tjera europiane, 92% mendojnë se korrupsioni është problemi kryesor i vendit, 54% e shqiptarëve janë të ndikuar personalisht nga korrupsioni gjatë jetës së përditshme, 89% mendojnë se ka korrupsion në institucionet lokale, 88% mendojnë se ka korrupsion në institucionet kombëtare dhe 44% mendojnë se ka korrupsion brenda institucioneve të BE-së.
- 19% e shqiptarëve besojnë se gjatë 8 muajve të fundit korrupsioni është rritur ndjeshëm, 9% mendojnë se është rritur pak, 33% mendojnë se ka qëndruar njësoj, 32% mendojnë se është ulur pak, 4% mendojnë se ka rënë dhe 3% nuk e dinë.
- Në 8 muajt e fundit 32% të intervistuarve iu kërkua ose u prit që të paguanin ryshfet për të marrë një shërbim publik.
- Institucionet më të korruptuara që kërkonin ose prisnin ryshfete nga qytetarët në 8 muajt e fundit janë institucionet e shëndetit publik (13.9% e qytetarëve iu kërkua ose pritej prej tyre që të paguanin ryshfet), institucionet e arsimit publik (4,8%), politikanët (3.2%) dhe gjykatat (2.8%).

Avantazhet e metodologjisë

Ky studim ka pesë avantazhe kryesore, krahasuar me shumicën e sondazheve të kryera në terren në Shqipëri, kryesisht:

- *Kampion përfaqësimi më i mirë.* Nuk u lejua asnjë zëvendësim i personave të intervistuar që mund të shmangi deformimin e kampionit. Specifikimet e metodologjisë nuk lënë hapësira për preferencat individuale të intervistuesve në përzgjedhjen e banesave ose të intervistuarit.
- *Asnjë e dhënë që mungon ose e paqartë.* Shumica e studimeve sasiore të kryera në Shqipëri ende përdorin pyetësorët e bazuar në letër gjë që në shumë raste shkakton probleme. Përdorimi i Tabletit dhe përdorimi i pyetësorit elektronik shmang totalisht problematikat dhe ndikimet e intervistuesit.
- *Shmangia e gabimit në hedhjen e të dhënave.* Përdorimi i tabletave shmang hedhjen e të dhënave të gabuara në sistem nga operatorët dhe të gjitha të dhënat e mbledhura eksportohen drejtpërdrejt në SPSS.
- *Dekurajimi i kryerjes së intervistave të pandershme.* Gjatë kryerjes së intervistave, vendndodhja e intervistuesve monitorohej në kohë reale nëpërmjet teknologjisë dhe koordinatorëve për të ndjekur të gjitha specifikimet e metodologjisë dhe kampionimit. Kjo e bën të lehtë kapjen e intervistave të pavlefshme.
- *Kontrolli në terren i 30% të intervistave.* Zbatimi i metodologjisë kërkon rikontrollin nëpërmjet vizitave në terren 30% të intervistave sidomos për rastet e dyshimta.